

20231011915

Në bazë të nenit 68 paragrafi (8) pika b) dhe 99 paragrafi (2) të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm PENSIONAL me Financim Kapital (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 180/2019 dhe 103/2021) Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit PENSIONAL, në mbledhjen e mbajtur më 27.04.2023 miratoi

RREGULLORE PËR KOMPENSIME PËR FONDE TË DETYRUESHME PENSIONALE

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen më afërsisht kompensimet që i arkëtojnë shoqëritë e menaxhimit të fondeve të detyrueshme pensionale dhe shoqëritë e menaxhimit të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtutjeshëm: shoqëritë) dhe caktohet periudha kohore për të cilën mund të zvogëlohet lartësia e kompensimit nga kontributet e paguara në fondin e detyrueshëm pensional (në tekstin e mëtutjeshëm: kompensimi nga kontributet) të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional.

Kompensimet që i arkëtojnë shoqëritë

Neni 2

Shoqëria mund t’i arkëtojë nga secili anëtar i veçantë dhe nga secili i siguruar i shpërndarë përkohësisht në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin ajo shoqëri menaxhon, kompensimet në vijim:

a) Kompensimi nga kontributet të cilin shoqëria e arkëton nga secili kontribut të paguar në çdo llogari individuale ose në çdo nënlllogari individuale të llogarisë së veçantë para se ato kontribute në para të shndërrohen në njësi kontabël të fondit të detyrueshëm pensional dhe

b) Kompensimi mujor nga vlera e mjeteve totale neto të fondit të detyrueshëm pensional (në tekstin e mëtutjeshëm: kompensim për menaxhimin e mjeteve).

Neni 3

Kur mjetet nga nënllogaria individuale transferohen në llogarinë individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional, ato nuk konsiderohen si kontribut dhe për to nuk paguhet kompensim.

Neni 4

(1) Kompensimi nga kontributet dhe kompensimi për menaxhimin e mjeteve, të caktuara nga shoqëria, nuk mund të jenë më të larta se lartësia maksimale e kompensimeve të caktuar me Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm PENSIONAL me Financim Kapital (në tekstin e mëtutjeshëm: ligji).

(2) Nëse shoqëria nuk cakton ndonjë nga kompensimet e paragrafit (1) të këtij neni, e arkëton kompensimin maksimal të caktuar me ligjin.

(3) Shoqëria i përcakton shumat e kompensimit nga kontributet, kompensimit për menaxhimin e mjeteve dhe kompensimit për kalim si dhe shumën e zvogëlimit të kompensimit të kontributeve në bazë të gjatësisë së anëtarësimit në fondin e detyrueshëm pensional me statutin e fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon dhe ato i publikon në prospektin informativ.

Neni 5

(1) Kompensimi nga kontributet konsiderohet se është fituar kur kontributet janë aplikuar nga ruajtësi i pronës së fontit të detyrueshëm adekuat pensional dhe janë aprovuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) dhe arkëtohet çdo ditë pune. Kompensimi nga kontributet përllongarit me shumëzim të përqindjes së kompensimit nga kontributet që arkëtohet me shumën e kontributeve të paguara në çdo llogari individuale ose nënllongari individuale, varësisht nga rasti dhe arkëtohet me zvogëlim të shumës së përllongarit nga kontributet e paguara, çdo ditë kur pranohen kontribute.

(2) Kompensimi i menaxhimit të mjeteve konsiderohet se është fituar në çdo datë të vlerësimit, e arkëtohet çdo ditë të pestë të punës në muajin pas vlerësimit. Kompensimi për menaxhimin e mjeteve përllongarit në çdo datë të vlerësimit me pjesëtim të kompensimit nga neni 2 pika b) të kësaj rregulloreje me numrin e datës së vlerësimit në atë muaj dhe pastaj rezultati shumëzohet me vlerën e mjeteve neto të fondit të detyrueshëm pensional.

Mënyra dhe koha e pagesës së kompensimeve të shoqërive

Neni 6

(1) Çdo ditë pune Agjencia i jep ruajtësit të pronës informatë për kompensimin e kontributeve që është arritur dhe që duhet të paguhet. Pas pranimit të faturës nga shoqëria për këtë kompensim, ruajtësi i pronës, ditën e njëjtë e bën pagesën adekuate nëse shuma e faturës është e barabartë me shumën e dhënë nga Agjencia.

(2) Ruajtësi i pronës, çdo ditë pune në muaj, bën përllongaritje të kompensimit për menaxhimin e mjeteve të fondit pensional që është arritur dhe që duhet ta transferojë në llogarinë e shoqërisë.

(3) Çdo shoqëri parashtron faturë, për çdo muaj, te ruajtësi i pronës, për pagesë të kompensimit për menaxhimin e mjeteve, të përllongarit në përputhje me nenin 5 paragrafi (2) të kësaj rregulloreje në mënyrën në vijim:

a) fatura parashtronet në afat prej tre ditë pune nga dita e fundit e punës në muajin;

b) pas pranimit të faturës, ruajtësi i pronës në ditën e njëjtë e paguan kompensimin për menaxhimin e mjeteve të shoqërisë nëse shuma e faturës është e barabartë me përllongaritjen e bërë nga ruajtësi i pronës.

(4) Ruajtësi i pronës e njofton shoqërinë dhe Agjencinë, për shumën e kompensimit nëse shuma e faturës nuk është e barabartë me shumën e informatës nga Agjencia dhe përllongaritjen e bërë nga ruajtësi i pronës. Nëse nevojitet korrigjim i shumës së faturës, shoqëria menjëherë dorëzon faturë të re, me ç'rast ruajtësi vepron në përputhje me paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni.

Zvogëlimi i kompensimit nga kontributet në bazë të gjatësisë së anëtarësit në fondin e detyrueshëm pensional

Neni 7

Kompensimi nga kontributet mund të zvogëlohet për anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional të cilët kanë qenë vazhdimisht anëtarë të atij fondi të detyrueshëm pensional në periudhat kohore të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje. Zvogëlimi i kompensimit nga kontributet bëhet në mënyrën e barabartë për të gjithë anëtarët që kanë qenë anëtarë në fondin e njëjtë të detyrueshëm pensional në periudhën e njëjtë kohore.

Neni 8

Zvogëlimi i kompensimit nga kontributet paraqet zvogëlim procentual të shkallës së kompensimit nga kontribute (për shembull, nëse kompensimi aktual nga kontributet është 4% nga kontributet e paguara dhe zvogëlimi është 10%, kompensimi i ri nga kontributet është: $4\% \times 0,9 = 3,6\%$).

Neni 9

(1) Çdo shoqëri e aplikon zvogëlimin e kompensimit nga kontributet sipas kësaj tablele:

Numri i ditëve	Përqindja e zvogëlimit
$0 < \text{numri i ditëve} \leq 360$	a %
$360 < \text{numri i ditëve} \leq 720$	b %
$720 < \text{numri i ditëve} \leq 1080$	c %
$1080 < \text{numri i ditëve} \leq 1440$	d %
$1440 < \text{numri i ditëve} \leq 1800$	e %
$1800 < \text{numri i ditëve} \leq 2160$	f %
numri i ditëve > 2160	g %

(2) Kompensimi nga kontributet nuk mund zvogëlohet me kohëzgjatje të rritur të anëtarësisë (përkatësisht në tabelën me përqindjet për zvogëlim, të dhënë më lartë: : $a \leq b \leq c \leq d \leq e \leq f \leq g$).

(3) Numri i ditëve përlllogaritet nga data kur anëtari ka fituar statusin e anëtarit në fondin e detyrueshëm pensional.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, gjatë anëtarësimit të parë në fondin e detyrueshëm pensional, numri i ditëve përlllogaritet nga dita e parë në muajin për të cilin anëtari ka fituar të drejtën e kontributit në fondin e detyrueshëm pensional.

Ndryshime në kompensimet të cilat i arkëtojnë shoqëritë

Neni 10

(1) Shoqëria është e detyruar që t'i dorëzojë Agjencisë kërkesë për miratim të zvogëlimit ose rritjes së përqindjes së kompensimit të kontributeve. Pas pranimit të miratimit nga Agjencia, shoqëria është e detyruar që ta publikojë ndryshimin së paku në njërën prej gazetave ditore me më shumë tirazh që del në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, shoqëria nuk dorëzon kërkesë për miratim, nëse e arkëton kompensimin maksimal të caktuar me ligjin. Shoqëria është e detyruar ta publikojë ndryshimin e kompensimit të caktuar ligjor, në afat prej pesë ditë pune nga dita e ndryshimit të kompensimit, së paku në njërën prej gazetave ditore me më shumë tirazh që del në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Neni 11

(1) Zvogëlimi i përqindjes së kompensimit nga kontributet fillon të aplikohet nga data 1 në muajin që vijon më së shumti një muaj pas muajit në të cilin është publikuar ndryshimi.

(2) Rritja e përqindjes së kompensimit nga kontributet fillon të aplikohet nga data 1 në muajin që vijon gjashtë muaj pas publikimit të parë të ndryshimit.

Neni 12

(1) Pasi të publikohet ndryshimi, vendimi për zvogëlim të përqindjes së kompensimit nga kontributet, nuk mund të anulohet para datës së fillimit të aplikimit.

(2) Shoqëria duhet ta njoftojë Agjencinë nëse e anulon rritjen e kompensimit nga kontributet para datës së aplikimit dhe ta publikojë së paku në njërën prej gazetave me më shumë tirazh që del në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në atë rast, shoqëria mund ta rrisë përsëri kompensimin nga kontributet, pas skadimit të së paku dy muajve nga data e publikimit të anulimit.

Neni 13

(1) Shoqëria dorëzon njoftim me shkrim te çdo anëtar i cili ka llogari individuale në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon për çdo vendim për rritjen e përqindjes së kompensimit nga kompensimet, në datën e njëjtë kur njoftimi është publikuar në njëërën prej gazetave ditore me më shumë tirazh. Njoftimi publikohet edhe në ueb faqen e shoqërisë.

(2) Shoqëria i dorëzon kopje të njoftimit të paragrafit (1) të këtij neni çdo personi që ka për qëllim të nënshkruajë kontratë për anëtarësim me atë shoqëri para nënshkrimit të kontratës për anëtarësim nga ai person.

Dispozita përfundimtare

Neni 14

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi një ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për kompensimet për fondet e detyrueshme pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 100/2013 , 25/2014 dhe 32/2018)

Nr. 01-677/4
28.4.2023
Shkup

Kryetar
i Këshillit të Ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.